

RAPORT TEKNIK

PROJEKTI: MBESHTETJE PER NGRITJEN E POLEVE
TE ZHVILLIMIT TE INTEGRUAR RURAL NE
PARTNERITETET ME NJESITE E VETEQEVERISJES
VENDORE DHE AKTORE TE TJERE LOKALE DHE
QENDR ORE FERMA E DIJES DHE AGROTURIZMIT TE
MOLLEVE, KORVE-FAZA II.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
2. POZICIONI GJEOGRAFIK.....	4
3. GJENDJA EKZISTUESE	4
3.1 FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE.....	5
3.2 RILEVIMI TOPOGRAFIK.....	7
4. PROPOZIMI PER PROJEKTIN E RI.....	8
4.1 MASTERPLANI.....	9
4.3 KAPANONI.....	10

TABELA E FIGURAVE

Figure 1. Harta e qytetit të Korçës.....	4
Figure 2. Vendndodhja në lidhje me qytetin e Korçës.....	5
Figure 3. Foto të gjendjes ekzistuese.....	6
Figure 4. Foto të gjendjes ekzistuese.....	6
Figure 5. Foto të gjendjes ekzistuese.....	7
Figure 6. Foto të gjendjes ekzistuese.....	7
Figure 7 Rilevimi Topografik.....	8
Figure 8 Masterplan.....	9
Figure 9. Panele diellore të instaluar në tarracat dhe çatitë e ndërtesave	10
Figure 10. Plani i organizimit funksional të Kapanonit Kati 0	12
Figure 11. Plani i organizimit funksional të Kapanonit Kati	Error! Bookmark not defined.
Figure 12. Plani i Catise, Kapanoni	12
Figure 13. Fasada Perendimore, Kapanoni	13
Figure 14. Fasada Lindore, Kapanoni	13
Figure 15. Fasada Veriore, Kapanoni	13
Figure 16. Fasada Jugore, Kapanoni	13
Figure 17. Prerja 1-1, Kapanoni	14
Figure 18. Prerja 2-2, Kapanoni	14
Figure 19. Prerja 3-3, Kapanoni	Error! Bookmark not defined.

1. HYRJE

Ky projekt synon krijimin e një ferme moderne të mollëve, duke përdorur teknika të avancuara të bujqësisë dhe një dizajn arkitektonik që mbështet qëndrueshmërinë dhe integrimin në mjedisin natyror.

Fermat e mollëve përfaqësojnë një kombinim të mrekullueshëm mes teknologjisë dhe natyrës, me ndërtime që pasqyrojnë harmoni me peisazhin rural. Në këtë relacion, fokusi është vendosur mbi aspektet arkitektonike, përfshirë planifikimin hapësinor, dizajnin e strukturave dhe peisazhit, si dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të projektit.

Dizajni është menduar për të optimizuar funksionalitetin e fermës, duke i dhënë përparësi ruajtjes së energjisë dhe përdorimit të materialeve ekologjike.

Ferma e Mollëve do të jetë një vend i hapur për të gjithë:

- Për fermerët: Ferma do të ofrojë mundësi për të mësuar dhe shkëmbyer njohuri për teknikat e reja të bujqësisë, duke ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe të cilësisë së prodhimit.

- Për konsumatorët: Ferma do të sigurojë produkte të freskëta dhe të cilësisë së lartë, duke i siguruar konsumatorëve ushqim të shëndetshëm dhe të prodhuar lokalisht.

- Për turistët: Ferma do të jetë një vend atraktiv turistik, duke ofruar mundësi për rekreacion, edukim, dhe shijimin e bukurive natyrore.

- Në të ardhmen:

Ferma e Mollëve synon të jetë një model i qëndrueshmërisë në bujqësi, duke promovuar praktikat miqësore me mjedisin dhe duke kontribuar në zhvillimin e ekonomisë rurale.

Një qendër e prodhimit të mollëve të cilësisë së lartë: Duke përdorur teknika moderne bujqësore, Ferma do të rrisë sasinë e prodhimit dhe cilësinë e mollëve, duke krijuar një markë të njohur dhe të besueshme në treg.

Një destinacion atraktiv turistik: Duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh rekreative dhe edukative, Ferma do të jetë një atraksion i fortë për turistët e brendshëm dhe të huaj, duke ndihmuar në zhvillimin e turizmit ruralë.

Një platformë për inovacionin bujqësor: Duke bashkëpunuar me institucione kërkimore dhe universitete, Ferma do të promovojë zhvillimin e teknologjive të reja bujqësore, duke ndihmuar në rritjen e konkurrencës së sektorit bujqësor.

Një partner i besueshëm për komunitetin: Duke krijuar punësimin dhe duke ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë së komunitetit, Ferma do të jetë një faktor kyc; për mirëqenien e zonës.

2. POZICIONI GJEOGRAFIK

Korça është një qytet në Shqipërinë Jug-Lindore. Korça është edhe qendra e prefekturës me të njëjtin emër. Është një nga bashkitë më të mëdha të vendit me rreth 90.000 banorë të regjistruar.



Figure 1. Harta e qytetit të Korçës.

3. GJENDJA EKZISTUESE

Zona ku do të zhvillohet projekti I Fermës së Dijes ndodhet në afërsi të fshatit Qatrom, vetëm 5.4 km larg qytetit të Korcës. Terreni ku do të ngrihet ferma e mollëve

karakterizohet nga një topografi e lehtë, me tokë pjellore dhe akses ndaj burimeve të ujit. Zona është e pandërtuar dhe rrethohet nga një rrugë perimetrale e pashtuar. Ajo ndodhet shumë pranë rrugës interurbane, por është e nevojshme një infrastrukturë rrugore për aksesin në Fermën e Mollëve.



Figure 2. Vendndodhja në lidhje me qytetin e Korçës

3.1 FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE



Figure 3. Foto të gjendjes ekzistuese



Figure 4. Foto të gjendjes ekzistuese



Figure 5. Foto të gjendjes ekzistuese



Figure 6. Foto të gjendjes ekzistuese

3.2 RILEVIMI TOPOGRAFIK

4.1 MASTERPLANI



Figure 8 Masterplan

Peizazhi i fermës është menduar për të ofruar një mjedis estetik dhe funksional. Përveç rreshtave të mollëve, janë krijuar shtigje për lëvizjen e makinave bujqësore dhe kënde për punonjësit. Ndërsa plantacionet dominojnë peizazhin, janë lënë zona me vegetacion natyror për të ruajtur biodiversitetin lokal. Organizimi i hapësirave të gjelbërta është bërë në mënyrë të tillë që të lehtësohet kullimi natyral i ujërave.

Ndërtesat e fermës janë dizajnuar në përputhje me standardet më të larta të qëndrueshmërisë. Strukturat përfshijnë magazinat për ruajtjen e pajisjeve, hapësirat për përpunimin e prodhimeve dhe ndërtesat e punonjësve. Dizajni i këtyre ndërtesave bazohet në përdorimin e materialeve lokale dhe të qëndrueshme, të cilat janë të përshtatshme për klimën dhe mjedisin rural. Përveç kësaj, është planifikuar instalimi i paneleve diellore për të plotësuar nevojat energjetike të fermës.




Figure 9. Panele diellore të instaluar në tarracat dhe çatitë e ndërtesave

4.3 KAPANONI

Objekti përbën një kapon magazinimi të dedikuar për ruajtjen dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore, kryesisht mollë.

Kapanoni është konceptuar si një hapësirë funksionale, me akses të lehtë për mjete bujqësore, ngarkim–shkarkim dhe manovrim brenda territorit të fermës.

Ndërtesa është njëkatëshe, me strukturë mbajtëse metalike (kolona dhe trarë çeliku), si dhe mure dhe çati me panele sanduiç, duke garantuar izolim termik të përshtatshëm për kushtet e magazinimit.

Magazinimi dhe Përgatitja e Lëngut të Mollës

Përshkruhen zonat e dedikuara për magazinimin e mollëve dhe përgatitjen e lëngut të mollës.

Hapsira e magazinimit (open-space)

-Hapësirë e vetme e madhe, pa ndarje të brendshme strukturore.

-Paramenduar për depozitimin e produkteve bujqësore në arka/paleta.

-Lartësi e brendshme e përshtatshme për manovrim të mjeteve të vogla të ngarkim-shkarkimit (forklift).

-Dysheme e betonuar industriale me rezistencë ndaj ngarkesave dinamike dhe statike.

Blloku sanitar (tualetet e stafit)

I vendosur në një zonë të brendshme të kapanonit, me qasje të veçantë.

Përmban:

-Tualet për staf

-Lavaman

-Hapësirë të vogël teknike për instalime sanitare

Dritaret dhe elementët e hapjeve

Dritare të vendosura në anët e kapanonit për ventilim natyral dhe ndriçim pasiv.

Dyer hyrëse me panel sanduic dhe porta industriale për ngarkim-shkarkim, sipas planimetrisë.

Objekti i projektuar është funksional, ekonomik dhe i përshtatur për qëllimin e tij si magazinë për prodhime bujqësore. Struktura metalike, panelet sanduic dhe organizimi i brendshëm pa ndarje mundësojnë fleksibilitet, mirëmbajtje të lehtë dhe funksion optimal të procesit të depozitimit.




Figure 10. Plani i organizimit funksional të objektit të përpunimit Kati 0




Figure 11. Plani i Catise, Objekti i Përpunimit




Figure 12. Fasada Perendimore, Objekti i Perpunitimit




Figure 13. Fasada Lindore, Objekti i Perpunitimit




Figure 14. Fasada Veriore, Objekti i Perpunitimit



Figure 15. Fasada Jugore, Objekti i Perpunitimit




Figure 16. Prerja 1-1, Objekti i Perpunimit




Figure 17. Prerja 2-2, Objekti i Perpunimit

AMBJENTI TEKNIK

Ambienti teknik përbën një komponent thelbësor të projektit të fermës së mollëve, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të të gjithë kompleksit.

Në këtë ambient parashikohen instalimet kryesore teknike, përfshirë sistemet elektrike, mekanike, hidraulike dhe të ventilimit, si dhe hapësirat për pajisjet e kontrollit dhe mirëmbajtjes. Organizimi funksional i ambientit teknik është projektuar në mënyrë që të sigurojë akses të lehtë për shërbime teknike, ndërhyrje periodike dhe mirëmbajtje, pa ndërprerë aktivitetin e përditshëm të fermës dhe objekteve të lidhura me të.

Vendosja dhe dimensionimi i ambientit teknik janë realizuar në përputhje me kërkesat funksionale të fermës së mollëve dhe të kapaciteteve të përpunimit, duke respektuar standardet teknike dhe kushtet e sigurisë. Ky ambient shërben si nyje mbështetëse e gjithë infrastrukturës së projektit, duke kontribuar drejtpërdrejt në eficiencën operacionale dhe zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit agro-industrial.

